

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEGA SUHAREKË, Gjyqtari Qemail Suka, me pjesëmarrjen e Sek. Juridike Vjollca Haziraj, në lëndën penale sipas P.Th.nga Prizreni Aktakuzës **PP.nr. PP.nr.51-3/16 te dt. 11.05.2016**, ndaj te akuzuarit D. K. nga fsh. Z. KK Rahovec, për shkak te veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 parag. 6 lidhë me parag. 1 te KP-se, në prezencë të prokurorit te PTH-ës nga Prizreni Musli Gashi dhe te akuzuarit, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, te mbajtur me dt.14.02.2018, mori publikisht shpalli dhe me date 14.02.18 përpilo këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari D. K., nga i ati M., e ema S., e lindur D., i lindur me dt. 02.05.1995 ne Z., ku dhe tani jeton, me numer personal, i pa martuar, ka te kryer shkollen e mesme, i pa pune, i gjendjes se dobet ekonomike, i pa dënuar me pare, shqiptar, shtetas e Republikës se Kosovës, i pa dënuar me pare, shqiptar, shtetas e Republikës se Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se me dt. 23.12. 2015 rerth orës 10.20 minuta ne rrugën rajonale Suhareke – Rahovec saktësisht te vendi i qujtur “G.” te fsh. S. rrezikon trafikun publik duke shkelur nenet 54 dhe 68 te ligjit per siguri ne komunikacion rrugor dhe vene ne rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, ne ate menyre qe duke drejtuar automjetin e udhetareve te markes “VW” te tipit “g. 19”E me targa te regjistrimit ...-KS-..., me ngjyre te kaltert, i cili duke mos e përshtatur shpjetesin ene raport me kushtet dhe me rrehanat rrugoe dhe mos mbajtjes se distancës se duhur e godet nga mbrpa veturën e markes “M. B.” te tipit “200E”, me targa te regjistrimit 04-...-AB, me ngjyre te zeze metalike te cilen e drejtonte A. J., me qrast përpos demve materiale ne atuomjete te dëmtuarit pësojnë lëndime te lehta trupore dhe ate A. J., përdredhje te indeve te buta te qafës dhe kafazi te kraharorit.

Me këtë ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paraga. 6 lidhur me paraga. 1 te KP-es.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 41,51,52, 73,74 KP si dhe 359 parag. 1 dhe 2,dhe neni 378 KPK-se të akuzuarit, i shqipton :

D Ë N I M M E K U S H T

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim prej 2 (dy) muajve,i cili dënim nuk do te ekzekutohen në afatin e verifikimit prej një viti nëse i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale.

Obligohet i akuzuari qe ne emër te paushallit gjyqësor, te paguaj shumen prej 20 €, pas plotfuqishmërisë se këtij Aktgjykimi.

Udhëzohet pala e dëmtuar, A.J. që kërkesën pasurore-juridike ta realizojë në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

PTH-e me aktakuze, **PP.nr. 51-3/16 te dt. 11.05.2016**, ndaj të akuzuarit D. K. nga fsh. Z. KK Rahovec, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragraf 6 lidhur me paragraf 1 të KP-se, të cilin gjatë seancës së shqyrtimit fillestare e ka përfaqësuar PSH nga Prizreni Musli Gashi i cili në tërësi ngel pranë të dhënave si në aktakuze, që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata në shqyrtimin e sotëm dhe me vet pranimin nga ana e të akuzuarit ka vërtetuar këtë gjendje faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vet pranimi i të akuzuarit i cili në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 257 të KPP-se në shkresat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë provë të pa pranueshme dhe po ashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajit nga ana e të akuzuarit, është bërë vullnetarisht në shqyrtimin fillestar, pranimi është mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza, të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe provat materiale të paraqitura ndaj të akuzuarit nga ana e PTH-se në Prizren.

Gjykata po ashtu në tërësi ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë në shqyrtimin fillestar nga ana e të akuzuarit, është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 248 të KPP-se, nga se nuk ekziston ndonjë nga arsyeset dhe kushtet për hüdhen e aktakuzës, apo pushimin e procedurës penale.

Nga këto fakte të cilat i përmbanë aktakuza, Gjykata ka ardhur në përfundim se me veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragraf 6 lidhur me paragraf 1 të KP-es, andaj Gjykata ka vendosur të akuzuarin të shpallet fajtor dhe t'ia shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KP-se, të cilat ndikojnë në lartësinë e dënimit.

Gjykata si rrethane lehtësuese mori për bazë se i akuzuari ka pasur qëndrim korrekt ndaj Gjykatës, ka bërë pranimin e fajësisë në mënyrë vullnetare, është penduar për veprën e kryer, është hera e parë që bie ndesh me Ligjin.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike e mori në kuptim të nenit 463 të KPP-se . Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u mori në kuptim të nenit 452 paragraf 1 të KPP-se.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA SUHAREKE

Gj y q t a r i
Qemail Suka

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.